



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija

Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; [kqz.sekretariati@kqz-ks.org](mailto:kqz.sekretariati@kqz-ks.org); [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

## KRYETARJA NESRIN LUSHTA KA MARRË DETYRËN

17.05. 2009

Kryetarja e re Komisionit Qendrorë Zgjedhorë Nesrin Lushta, është takuar të premten e kaluar me anëtarët e KQZ-së, dhe me strukturat e SKQZ-së. Lushta, pasi që është përshëndetur me anëtarët e KQZ-së dhe me personelin tjetër të SKQZ-së, ka zhvilluar një takim kryesisht jozyrtar-njohës. Anëtarët e KQZ-së, e kanë njoftuar shkurtimisht Lushtën me kornizat kryesore të funksionimit të KQZ-së, me punën që aktualisht bëhet dhe sidomos me rolin që ka ky organ i pavarur. Kryetarja Nesrin Lushta, pasi që ka i ka falënderuar të gjithë, ka kërkuar që aktiviteti dhe puna të vazhdoj në KQZ si edhe më përpara dhe, të dinamizohet sa më shumë KQZ, sidomos tani duke qenë se vendi është në prag të shpalljes së Zgjedhjeve Lokale. Presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, e emëroi më 14 maj Nesrin Lushtën në krye të Komisionit Qendror Zgjedhor, pas dorëheqjes së parevokueshme të z. Zait Xhemajlit nga ky post. Të njëjtën ditë, kryetarja e re e KQZ-së, e dhe betimin përpara Presidentit dhe anëtarëve të KQZ-së, në orën 13:00.

### ***Biografia e shkurtër e Kryetares së re të KQZ-së***

*Nesrin Lushta ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Prishtinë në vitin 1982, dhe ka punuar si gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë deri në vitin 1992. Më pas, për nëntë vite ajo ushtroi punën e avokates. Në vitin 2001, ajo u emërua Drejtoreshë e Institutit Kosovar të Gjyqësisë. Në vitet 2004- 2006, Nesrin Lushta ishte anëtare e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë së Kosovës, ndërsa ka qenë konsulent dhe eksperte për disa institute dhe organizata ndërkombëtare.*